




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari

Duke u bazuar në nenin 17, pika (s), nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale; Nenit 37, pika 1.19 të Statutit të Komunës së Gjiçanit 01.nr.016-126211 datës 06.11.2014; Rregullores Komunale për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve 01.nr.016-33484 e datës 28.03.2024, Kryetari i Komunës me datë 19.06.2025 merr :

V E N D I M

Për miratimin e dhënies së subvencioneve për fermerët prodhues të qumështit për periudhën një vjeçare (Janar-Dhjetor) 2024, në kuadër të implementimit të projektit:
"Subvencionimi i Qumështit për litër 0.10 €/L"

1. **APROVOHET**, lista e përfitueseve sipas Raportit të Komisionit Vlerësues të datës 11.06.2025, me nr. protokolli 02/763 për Miratimin e Dhënies së Subvencioneve në lëmine e bujqësisë- për fermerët prodhues të qumështit, për periudhën një vjeçare 2024 .
2. Pagesa bëhet nga Kodi Buxhetor 22200 (Kodi ekonomik për subvencione) nga Projekti i Subvencioneve të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, sipas pikës 1 të këtij Vendimi.
3. Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria e Buxhetit dhe Financave në Gjiçan, në pajtim me dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.4 të Ligjit nr.03/L-048 Për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi.
4. Vendimi hynë në fuqi nga dita e nënshkrimit dhe protokollimit nga ana e Kryetarit të Komunës.
5. Vendimit i bashkëngjitet Raporti i Komisionit Vlerësues me nr. 02/763 i datës 11.06.2025 për Miratimin e Dhënies së Subvencioneve në lëmine e bujqësisë-për fermerët prodhues të qumështit, për periudhën një vjeçare 2024 së bashku me listën e përfitueseve (1-45) të qumështit.

T'i dorëzohet :

- Zyrës së Kryetarit
- DBF
- DBP

